


Kur dhe në cilat gjuhë interpretohet?

Shërbimet e interpretimit mund të përdoren gjatë ditëve të javës nga ora 7:00 e mëngjesit deri në orën 7:00 pasdite – gjithashtu gjatë muajve të verës.

- Gjithsej ofrohen 34 gjuhë të ndryshme përfshirë gjuhën e shenjave).
- Përkthimi në një nga 17 gjuhët më të përdorura (si turqisht, boshnjakisht/kroatisht/serbisht, arabisht, dari, farsi etj.) është i mundur brenda pak minutash.
- Për gjuhët e tjera, takimi zakonisht mund të rezervohet brenda disa ditësh. Qofshin edhe gjuhë më të rralla (si p.sh. hindisht, urdu) janë të përfshira në shërbim.
- Të gjitha informacionet i gjeni gjithashtu në www.bmbwf.gv.at/videodolmetsch



A janë bisedat konfidenciale?

Po. Në interes të mbrojtjes së të dhënave, interpretimi zhvillohet përmes një sistemi të koduar. Përmbajtja e diskutimeve do të trajtohet në mënyrë konfidenciale dhe nuk do të regjistrohet apo kalohet tek të tjerët në asnjë rrethanë. Të gjithë përkthyesit e kualifikuar janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin dhe nënshkruajnë një deklaratë për mbrojtjen e të dhënave.



Ky projekt financohet nga Fondi Social Evropian si pjesë e përgjigjes së bashkimit kundër pandemisë së COVID-19.

Impressum

Pronari i medias, botuesi dhe redaktori:
Ministria Federale e Arsimit, Shkencës dhe Kërkimit
Minoritenplatz 5, 1010 Wien
+43 1 531 20-0
Dizajni: BKA Design & Grafik
Kredit për fotot: karo.linagraphic/Shutterstock.com (Cover)
Vjenë, mars 2021

bmbwf.gv.at/videodolmetsch

Ne kuptohemi!

Interpretimi me video ose telefon në institucionet arsimore fillore dhe shkolla

Informacione për prindërit dhe kujdestarët



Për çfarë shërben oferta?

Ndoshta ju ka ndodhur të jeni ndjerë i keqkuptuar gjatë një bisede me pedagogë/e ose nuk keni mundur të komunikoni shqetësimet tuaja aq qartë sa do të donit, sepse gjermanishtja nuk është gjuha juaj amtare. Meqenëse këto diskutime kanë të bëjnë me tema të rëndësishme si p.sh. zhvillimi dhe sukcesi i të mësuarit të fëmijës tuaj ose vendimin për arsimin e tyre të mëtejshëm, duhet të tërhiqen keqkuptimet gjuhësore.

Duke përdorur shërbimet e interpretimit, e gjithë përmbajtja e bisedës komunikohet qartë dhe saktë midis jush dhe institucionit arsimor të fëmijës tuaj nga përkthyes të kualifikuar.

Si funksionon biseda me përkthyes?

Biseda me ndihmën e një përkthyesi/e është shumë e thjeshtë: Mund të kryhet në institucionin arsimor me mbështetje interpretuese "të disponueshme" ose mund ta përdorni këtë ofertë në shtëpi. Për këtë do t'ju dërgohet një „Invite-Link“ ku përfshihet koha e interpretimit të planifikuar. Sapo ta klikoni, fillon interpretimi. Mund të përdoret në telefona smart, tableta, PC ose laptop. Nëse një interpretim kryhet përmes telefonit, gjithçka që duhet të bëni është t'i përgjigjeni thirrjes hyrëse.


Nuk ka nevojë të merren masa të tjera paraprake. Nëse keni ndonjë pyetje, ju lutemi kontaktoni institucionin arsimor të fëmijës suaj.

Cilat institucione arsimore mund ta përdorin këtë ofertë?

Oferta është e vlefshme për të gjitha **institucioneve arsimore fillore**, si dhe për të gjitha **shkollat publike dhe të mesme** në Austri.

Ju lutemi pyesni direkt në institucionin arsimor të fëmijës suaj nëse apo në çfarë mase është vënë në dispozicion kjo ofertë dhe i bëni me dije kërkesën tuaj për një interpretim.

Nëse ky shërbim nuk është ende i disponueshëm, institucioni arsimor mund të regjistrohet nëse është i interesuar për t'u bërë pjesë në bildung@savd.at.



Sa kushton oferta?



Ky projekt financohet nga Fondi Social Evropian si pjesë e përgjigjes së Bashkimit ndaj pandemisë

COVID-19, që do të thotë se nuk ka kosto për ju si një person privat për ta përdorur këtë shërbim.

Për cilat përmbajtje dhe si mund të përdoret oferta?

Shërbimet e interpretimit mund të përdoren në shumë mënyra: Sigurisht, kryesisht gjatë diskutimeve të planifikuara me pedagogë/e (p.sh. për biseda të detyrueshme fëmijë-prind-mësues), por edhe për biseda spontane, p.sh. pyetje që lindin kur merrni fëmijën tuaj. Oferta mund të thirret nga institucioni arsimor për kontakt individual (p.sh. për ditët e takimit me prindër) si dhe për kontakt në grupe (p.sh. për mbrëmjet me prindërore).

